

Marrëveshje Transferimi
të Pjesëve të Kapitalit të shoqërisë "Sezon Dekor" Sh.p.k
(Transferimi i Kuotave)

Në Tiranë, sot më 18/08/2014, palët e kësaj Marrëveshjeje ranë dakort si më poshtë:

- **Shitësi: Z. Viktor Laska**, shtetas shqiptar, lindur më 19.02.1972, në Mirditë e banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. 031550713, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë "Sezon Dekor" sh.p.k;

dhe

- **Blerësit:**

1. **Z. Aleksandër Laska**, shtetas shqiptar, lindur më 04.04.1977 në Mirditë, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 024723721, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;


MEQËNËSE:

- A. Shitësi është ortak i vetëm e zotëron 3,000 Kuota që përfaqësojnë 100 % të Kapitalit të Shoqërisë "Sezon Dekor" Sh.p.k, një shoqëri ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L21327005P, me seli në Tiranë, Rr. "Sulejman Delvina", Nr.4, Tiranë, Shqipëri ("Shoqëria") me një kapital prej 3,000,000 (tre milion) lek, përbërë nga 3,000 kuota me vlerë prej 1,000 lekë secila.
- B. Blerësi dëshiron të transferojë në pronësi të tij 900 kuotat me një vlerë prej 900.000 lekë, që përfaqësojnë 30% të kapitalit të shoqërisë të zotëruara nga shitësi në shoqërinë "Sezon Dekor" Sh.p.k., siç përcaktohet në këtë marrëveshje.
- C. Në përputhje me Nenet e Statutit të Shoqërisë dhe në mbështetje të Ligjit shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Nr. 9901, datë 14.04.2008, palët bien dakort si më poshtë:
 1. Shitësi deklaron se ka marrë nga Blerësi në mënyrë të plotë të gjithë çmimin e blerjes të rënë dakord në vlerën nominale të kuotave të transferuara dhe për këtë arsye transferon këtu 900 Kuota që përfaqësojnë 30 % të Kapitalit të zotëruara prej tij në Kapitalin e Shoqërisë "Sezon Dekor" Sh.p.k., me çmim total 900.000 lekë, në pronësi të Blerësit. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se Kuotat e transferuara këtu, janë në pronësinë e tij të plotë ligjore dhe të lira nga barra, hipoteke apo pengje.
 2. Blerësi pranon pronësinë e këtyre Kuotave në shitje, duke njohur gjendjen e Shoqërisë dhe bie dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i këtyre Kuotave brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar.
 3. Me nënshkrimin e kësaj akt-marreveshje, ortakë të shoqërisë bëhen:

- **Z. Viktor Laska**, zotërues i 2.100 kuotave që perfaqësojnë 70 % të kapitalit të shoqërisë "Sezon Dekor" Sh.p.k;
 - **Z. Aleksandër Laska**, zotërues i 900 kuotave që perfaqësojnë 30 % të kapitalit të shoqërisë "Sezon Dekor" Sh.p.k;
4. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të këtyre Kuotave objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si dhe në çdo autoritet tjetër sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

Kjo Marrëveshje u hartua në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Marrëveshja bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Nr. 9901, datë 14.04.2008. Marrëveshja u lexua nga palët, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht.

Viktor Laska

SHITËSI




Aleksandër Laska

BLERËSI
